



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:043522
Datë: 13.03.2024
Numri i dokumentit: 05448350
C.nr.95/2021

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, si civile në përbërje me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, në kontestin e paditësit Sh.K. nga fshati..., komuna Skenderaj, të cilin e përfaqëson me autorizim A.F. avokat në Prishtinë, kundër të paditurës B..., me seli ne Prishtinë që e përfaqëson me autorizim F.K. nga Prishtina, për kompensim të dëmit nga auto përgjegjësia, pas mbajtjes dhe përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor me pjesëmarrjen e palëve ndërgjyqëse me dt.24.01.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.K. nga fshati..., komuna Skenderaj.

II. DETYROHET e paditura B... me seli në Prishtinë që paditësit Sh.K. ne emër te dëmit te shkaktuar ne aksidentin e datës 22.01.2021 rreth orës 11:30 ne Rr... Skenderaj, me fajin e vetëm te të siguruarit te paditurës G.A. nga Skenderaj i cili gjatë drejtimit te automjetit te tipit Golf nga pakujdesia shkakton aksident trafiku duke i shkaktuar lëndime trupore paditësit, dhe mbi bazë të fajit e paditura duhet ti kompensoj dëmin material dhe jo material ne shumat si ne vijim:

Dëmi jo material:

Për dhimbje fizike trupore, shumen prej 1900 euro.

Për friken e përjetuar, shumen prej 1600 euro.

Demi material:

Për ndihmën e personit te tretë, shumën prej 200 euro.

Për ushqimin e përforcuar, shumën prej 200 euro.

Gjithsejtë ne shumen prej 3,900(tre mijë e nëntëqind) euro, e cila shumë duhet te paguhet me kamatë ligjore ne normën prej 8% për dëmin material nga dita e ushtrimit të padisë me dt.02.03.2021 ndërsa për dëmin jo material nga dita e marrjes se aktgjykimit me dt.24.01.2024 , si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe atë, për padi 104 euro, taksë për padi 21 euro, për dy ekspertiza mjekësorë 400 euro, për dy përfaqësime ne dy seanca 270 euro, gjithsejtë ne shumën prej 795 euro.

III. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit mbi shumat e gjykuara si ne dispozitiv te aktgjykimit për te gjitha kategoritë zhdëmtuese sepse shumat e kërkuara janë të larta në raport me dëmin e pësuar, dhe në tersi është refuzuar kërkesëpadia për shërim klimatik banjore në shumën prej 600 euro në mungesë të provave materiale për të dëshmuar këtë dëm.

A r s y e t i m

Paditësi Sh.K. përmes përfaqësuesit me autorizim me dt.02.03.2021 ka ushtruar padi ne gjykate ne te cilën ka theksuar se me dt.22.01.2021 ne Skenderaj ne Rr... ka ndodhur aksident i komunikacionit ku janë shkaktuar dëme jo materialë dhe materiale. Ne këtë aksident është përfshire automjeti “Golf” me ngjyre te bardhe i cili ne momentin e aksidentit e ka drejtuar G.A. nga Skenderaj si dhe paditësi me automjetin “VV” transporter me targa te regjistrimit... Deri te aksidenti ka ardhë për shkak se drejtuesi i automjetit te siguruar te e paditura nuk i ka respektuar shenjat e komunikacionit me përparësi kalimi ne udhëkryq dhe i merr përparësi e kalimit automjetit qe e ka drejtuar paditësi si pasoje shkakton aksident te komunikacionit ne dem material dhe jo material. Prove për këtë padisë i është bashkangjitur raporti i aksidentit 2021-BR-31 i dt.22.01.2021.

Paditësi si pasoje e lëndimeve te pësuar trupore ka marre ndihme mjekësore fillimisht ne QKMF ne Skenderaj dhe pastaj ne Spitalin e Përgjithshëm ne Mitrovicë qe dëshmohet ne raportin mjekësore.

Pas nxjerrjes se provave me ekspertizë mjekësorë nga Dr. N.D. ortoped-traumatolog dhe Dr. Sh.M. psikiatër dhe duke marre për baze se me tutje për te paditurën nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, duke marr për baze faktin se nuk janë kontestuese provat e nxjerra provat me ekspertizë mjekësorë ne seancën e shqyrtimit kryesore me dt.09.01.2024 e beri precizimin e kërkesëpadisë ashtu qe i propozoj gjykatës qe pas administrimit dhe vlerësimit te provave te merr aktgjykim me te cilin do te aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe te detyrohet e paditura qe ti kompensoje demin ne shumat si ne vijim:

Për dhimbje fizike trupore shumen prej 2500 euro.

Për friken e përjetuar shumen prej 2000 euro, për ndihmën dhe kujdesin e huaj prej 30 dite shume prej 450 euro, për ushqimin e përforcuar për 30 dite shumen prej 450 euro, për rehabilitim fizikë shumen prej 600 euro ne shumen e përgjithshme prej 6000 euro. I kërkoj shpenzimet e procedurës kontestimore për padi 104 euro, për dy seanca 270 euro, për ekspertiza mjekësorë 400 euro dhe për taks për padi shumen prej 21 euro gjithsejtë 795 euro.

E paditura përmes përgjigjes ne padi te dt.07.12.2023 e kundërshtoi ne tërësi kërkesëpadinë si për nga baza ashtu edhe për nga lartësia me pretendimin se raporti i aksidentit është fotokopje i palexueshëm, mungojnë provat tjerat veçanërisht fotot nga vendi i ngjarjes kështu qe kundërshtohet përgjegjësia ne shkaktim te aksidentit dhe ka kërkuar nga gjykata ta obligoj palën paditëse ne sigurimin e provave te përmendura me lartë.

Gjate shqyrtimit kryesor nuk i kundërshtoi mendimet dhe konstatimet e eksperteve mjekësor dhe palës paditëse i ofroi ofertën ne shumen prej 1200 euro për te lidhë pajtim gjyqësor për te gjitha kategoritë zhdëmtuese me arsyetim se kjo shume i përgjigjet natyrës se lëndimeve trupore duke i propozuar gjykatës qe mbi ofertën e dhëne te gjitha shumat e precizuara me kërkesëpadisë ti refuzoj si te pa bazuara. Sa i përket kamatës se kërkuar propozoi qe te vendoset prej kohës se marrjes se aktgjykimit e mbështetur ne mendimin e dhëne nga Gjykata Supreme e Kosovës, ndërsa sa i përket shpenzimeve te procedurës propozoj qe gjykata te vendos ne baze te neni 452 paragrafi 2 i LPK.

Gjykata me qellim te konstatimit te drejtë dhe te plotë te gjendjes faktike ne çështjen konkrete juridike ne kuptim te nenit 7 dhe 8 te LPK-se i nxori dhe administroi te gjitha provat e shënuara ne procesverbalin e seancës se shqyrtimit kryesor me date 09.01.2024 një nga një dhe te gjitha se bashku duke i krahasuar njërën me tjetrën nga te cilat rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e pjesërisht e bazuar.

Ne mes te palëve ndërgjyqëse pas provave te administruara rezulton se nuk është kontestuese baza juridike e kërkesëpadiës se me datën 22.01.2021 rreth orës 11:50 ne rrugën... ka ndodhur një aksident i komunikacionit, ku janë përfshire i siguruari te paditurës duke drejtuar automjetin (A) “Golf”, ngjyre e bardhe i cili ne momentin e aksidentit e drejtonte G.A. nga Skenderaj, ndërsa automjetin (B) “W transporter” me targa... te cilin e drejtonte paditësi. Se i siguruari i te paditurës ishte shkaktar i aksidentit i vetëm i dëshmuar me faktin se e paditura nuk e kundërshtoi bazën juridike te kërkesëpadiës gjate shqyrtimit kryesor dhe palës paditëse për zgjidhjen e kontestit i ofroj ofertën ne lartësinë prej 1200 euro.

Përshkrimi i rrethanave dhe faktorëve qe kane ndikuar ne shkaktimin e aksidentit është vërtetuar nga raporti i aksidentit nr. 2021-BR-31 date 22.01.2021 që nuk është kontestuar nga e paditura.

Pasi qe baza juridike nuk është kontestuese për ndërgjyqësit, gjykata procedurën e provave e orientoi ne drejtim te konstatimit te natyrës se lëndimeve qe i ka pësuar paditësi dhe llojeve tjera te demit jo material dhe material.

Për vërtetim te këtyre fakteve gjykata caktoi nxjerrjen e provës me ekspertize nga ekspertet mjekësor Dr. N.D. ortoped – traumatolog dhe Dr. Sh.M. psikiatër.

Ekspertet mjekësor pas shikimit dhe vlerësimit te raporteve mjekësore ne shkresat e lëndës dhe ekzaminimit te drejtpërdrejtë te paditësit ne seance kryesore me date 09.01.2024, dhanë ketë mendim dhe konstatim:

Sipas ekspertit Dr. N.D. ortoped – traumatolog, paditësi ne aksidentin e komunikacionit ka pësuar lëndime trupore si vijon, shtypje dhe përdredhje e unazave te qafës, lëndim qe klasifikohet i natyrës së lehte trupor. Si pasoje e lëndimeve paditësi ka pësuar dhimbje fizike te intensitetit posaçërisht te rende 20 minuta nga momenti i aksidentit, marrjes se tij dhe dërgimit ne institucionin shëndetësor me atë afërt. Dhimbje fizike te intensitetit te rende ka pësuar ne kohëzgjatje 24 ore edhe përkundër marrjes se barnave kundër dhimbjes si dhe vendosjes se qafore. Dhimbjet e intensitetit te mesëm kane zgjate 6 dite qe janë shprehur gjate lëvizjes se kokës dhe qafës, paditësi ka përjetuar dhimbje gjate qëndrimit ulur edhe tentimit te ngritjes edhe përkundër marrjes se barnave kundër dhimbjes dhe mbajtjes se qafores. Dhimbjet e intensitetit te ulet ka pasur dhe ka ende here pas here dhe gjatë bartjes se ndonjë peshe, qëndrimit me te gjate ne pozita ulur si dhe posaçërisht gjate ndërrimit te kohës apo motit.

Shëmtim trupor nuk ka, ZAJ nuk ka.

Gjykata duke marre për baze natyrën e lëndimeve trupore, intensitetin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike bazuar ne vlerësimin mjekësor dhe duke marre për baze edhe te gjitha kriteret

dhe masat tjera vlerësuese për dhimbje fizike e aprovoi shumen prej 1,900 euro e cila është në pajtueshmëri të përafërt me dëmin e paditësit.

Sipas ekspertit mjekësor Dr. Sh.M. psikiatër pas vlerësimit të raporteve mjekësore në shkresat e lëndës rrethanat si ka ndodhur aksidenti dhe ekzaminimin e paditësit lidhur me friken dhe kohëzgjatjen e saj, konstatoi se është manifestuar frika primare e intensiteti posaçërisht të lartë në kohëzgjatje prej disa sekondave që përfshinë kohën nga momenti i perceptimit për goditje nga ana e automjetit tjetër e deri të goditja dhe vlerësimi i gjendjes, kjo frike me këtë intensitet dhe kohëzgjatje është rezultat i drejtpërdrejtë i rrezikut për humbjen e jetës.

Frika sekondare e intensiteti të lartë në kohëzgjatje 30 minuta që është koha e nevojshme për transportim dhe dhënie të ndihmës së parë mjekësore në institucionin me të afërt, kjo frike është rezultate i shqetësimeve për shkak të dhimbjeve të fituara me aksident dhe ata në regjionin e kokës dhe qafës. Frika sekondare e intensitetit të mesëm ka vazhduar të jetë prezentë në kohëzgjatje prej 3 jave, kohe kjo e nevojshme për marrjen e ndihmës mjekësore në QE në Mitrovicë, ku i është nënshtruar ekzaminimeve specialiste, është përshkruar terapi kundër dhimbjeve dhe i është rekomanduar bartja e qafës ortopedike. Po ashtu për shkak të situatës, paditësi gjatë periudhës kohore ka pasur një vizite ambulatorë specialiste të psikiatri i cila ka përshkruar terapi kundër frikës që ndërlidhet me aksidentin. Frika sekondare e intensitetit të ulët vazhdon të jetë prezentë edhe sot e kësaj dite në varësi të dhimbjeve të cilat mund të fitojnë në intensitet në varësi të pozitës caktuar trupore apo ndryshimin e motit.

Duke marrë për bazë mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjekësor i cili ka kontestuar se të paditësi janë manifestuar të gjitha kategoritë e frikës që kanë zgjatë për një kohë, gjykata duke marrë për bazë vlerësimin mjekësor e aprovoi shumen prej 1600 euro e cila është e përafërt me dëmin e pësuar nga frika e përjetuar.

Meqenëse me provat e administruara pa mëdyshje është vërtetuar dëmi jo material i pësuar nga paditësi, gjykata i zbatoi dispozitat e nenit 183 të LMD-së ku është përcaktuar shpërblimi në të holla i dëmit jo material *“për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të ZAJ, të shëmtimit, të cenimit të autoritetit, të nderit, të lirive ose të të drejtave të personalitetit, të vdekjes së personit të afërm si dhe i frikës gjykata po të konstatoj se rrethanat e rastit sidomos intensiteti i dhimbjeve dhe frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga shpërblimi i dëmit material si dhe nga mungesa e dëmit material”*.

Në përputhje me dispozitat 183 para 2 të LMD, gjykata është kujdesuar për të mirën e cenuar nga akti dëmtues dhe qëllimit që i shërben ky shpërblim që është në pajtueshmëri të plotë me lartësinë e dëmit jo material të aprovuar.

Sipas ekspertit mjekësor paditësit i është dashur ndihma e personit të tretë për 4 jave, kohe kjo gjatë se cilës ka mbajtur qafore, kjo ndihme iu ka dashur në ushqim dhe veshmbathje dhe mbajtje të higjienës personale dhe për këtë gjykata e aprovoi shumen prej 200 euro.

Për ushqimin e përforcuar i cili ka qene i nevojshëm për 4 jave i pasur me minerale, vitamina dhe proteina ne raport me ushqimin e rëndomtë për rikuperim me te shpejte te lëndimeve trupore, është aprovuar shuma prej 200 euro.

Sa i përket demit material dhe shpërblimit te tij ne shumat e aprovuara gjykata është bazuar ne dispozitat e nenit 179 paragrafi 1 te LMD-së.

Pasi qe e paditura e ka lidhur kontratën për sigurim te dëmeve nga autopergjegjsia me të siguruarin e saj – shkaktarin e aksidentit te komunikacionit, mbi ketë baze është e obliguar qe paditësit te i shpërblejë demin ne shumat e gjykuara si ne dispozitiv te këtij gjykimi.

Gjykata po ashtu është bazuar në dispozitat e nenit 136 paragrafi 1 i LMD-së ku është rregulluar shkaktimi i demit dhe baza e përgjegjësisë ku shprehimisht thuhet “*Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensoj, përveç se vërtetohet demi është shkaktuar pa fajin e tij* “. Ne rastin konkret nuk është kontestuese fakti se fajtori i vetëm ne shkaktimin e demit është i siguruari i te paditurës.

Gjykata me rastin e aprovimit te shumave për demin jo material dhe material kryesisht është i bazuar ne konstatimet e eksperteve mjekësor për natyrën e lëndimeve trupore friken dhe formave tjera te demit, ka marre për bazë praktikat gjyqësore dhe dispozitat e nenit 323 të LPK-së dhe Udhëzuesin për Caktimin e Kriteve Orientuese dhe Lartësinë e Shpërblimit te Drejtë ne te Holla te Demit Jo Material te Gjykatës Supreme te Kosovës nr.41/2023 te dt.27.02.2023, dhe ne faktin se paditësit demi i aprovuar do ti shërbej si satisfaksion për plotësimin e nevojave te tij me te mira materiale dhe sipas vlerësimit te gjykatës shpërblimi është ne pajtueshmëri te plote ne demin e pësuar.

Është refuzuar pjesa e kërkesëpadisë si e pabazuar mbi shumat e gjykuara ngase shumat e kërkuara për te gjitha kategoritë zhdëmtuese janë te larta ne raport me dëmin e pësuar dhe me praktikat gjyqësore.

Pjesa e kërkesëpadisë qe ka te beje me shërimin klimatik është refuzuar ne tërësi ngase paditësi nuk ka provuar me prova materiale për demin e pretenduar dhe shpenzimet e krijuara.

Gjykata i vlerësoi kundërshtimet e palës se paditur te cilat kanë te bëjnë me lartësinë e precizimit te kërkesëpadisë te cilat janë pjesërisht te bazuara, ndërsa kundërshtimet tjera te cilat kanë te bëjnë ne llogaritjen e kamatës për te gjitha format te demit nga dita e marrjes se vendimit sa i përket demit material nuk janë të bazuara ndërsa kundërshtimet tjera lidhur me shpenzimet e procedurës nuk janë të mbështetura ngase baza juridike e padisë nuk është kontestuese për palët dhe rrjedhimisht shpenzimet e procedurës bien në barrën e palës së paditur.

Vendimi qe pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës kontestimore ne shumat e specifikuar ne dispozitiv te këtij aktgjykimi është i bazuar ne dispozitat e nenit 449,452 paragrafi 1 i LPK-së, ndërsa vendimi qe e paditura dëmin jo material ta kompensoj me kamatën ne normën 8 % nga dita e marrjes se aktgjykimit dt.24.01.2024, ndërsa për demin material nga dita e ushtrimit te padisë me dt.02.03.2021 është i bazuar ne dispozitat e nenit 382 te LMD-se dhe Mendimi Juridik Për Kamatën Ligjore të Gjykatës Supreme nr.265/2020 dt.02.12.2020.

Me sa u tha me lartë konform dispozitave ligjore te përmendura me lartë dhe dispozitat e nenit 143 te LPK-se u vendos si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, DEGA NË SKENDERAJ,
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHEM.
C.nr.95/2021, me datë 24.01.2024**

Gjyqtari
Hajrullah Aruqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 dite nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, nëpërmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.